



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 203, datë 11.06.2020

PËR PËRSËRITJEN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË GJYQTARES {...} NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË DURRËS

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, në vendimet e tij nr. 98, datë 21.06.2019 dhe nr.194, datë 04.06.2020, si dhe duke mbajtur në konsiderate dhënien e pëlqimit të gjyqtares {...} me shkresën nr. 2652 prot., datë 08.06.2020, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtares {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, për një periudhë deri në 1 (një) vit.
2. Efektet e këtij Vendimi fillojnë nga data 22.06.2020.
3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares znj. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR